



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality



Hani i Elezit

02.Nr. 1987/2018

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës dhe nenin 58 paragrafi d), ekzekutimi i akteve komunale, Statutin e komunës së Hanit të Elezit neni, 67 paragrafi 2), Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M

Për ekzekutimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01.nr.528/2018

- I. Merret vendim për zbatimin e vendimit të kuvendit të komunës 01/nr.528/2018 për përcaktimin e varrezave të qytetit dhe pasi të përfundon procedura e shpronësimit të fillohet me dislokimi i varrezave nga parcela, përmes të cilës kalon autostrada Prishtinë – Hani i Elezit.
- II. Edhe pse Ministria e Planifikimit Hapsinor përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar rishqyrtimin e aktit administrativ ngase preambula duhet të plotësohet edhe me Ligjin e Planifikimit Hapsinor 04/L-174, duke marrë parasysh Rregullorën për shyrtingun administrativ të akteve të komunave 01/2016, përkatësisht nenin 8 paragrafin 11, ka kaluar afati ligjor i ligjshmërisë prej 15 ditëve dhe vendimi i komunës konsiderohet i plotfuqishëm.
- III. Urdhërohen drejtoritë përkatëse ajo e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Ambientit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike që të zbatojnë vendimin për përcaktimin e varrezave numër 01/528/2018.
- IV. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, MMPH dhe Arkivi i Komunës.

Data: 07.03.2018
Hani i Elezit

